

VENDIM
Nr. 90, datë 6.2.2013

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2013, PËR AUTORITETIN E
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 117 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2013, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, në shumën 273 300 000 (dyqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind mijë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitur në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha